

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Autoritetin e Aviacionit Civil, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko- financiare” për periudhën 01.01.2011 deri 31.03.2012, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 88 datë 12.06.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 466/15 datë 25.06.2012, dërguar [REDAKTUAR] Drejtor Ekzekutiv në Autoritetin e Aviacionit Civil , Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Nga auditimi i zbatimit të ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, në lidhje me statusin e “Autoritetit të Aviacionit Civil” si një ent publik me pavarësi financiare, e cila është një pikë e fortë që i krijon këtij enti mundësitë ekonomike për të përmbushur detyrimet që kërkon aviacioni civil sipas standardeve ndërkombëtare, duhet të revokohet paragrafi i fundit i nenit 18, pika 3 e ligjit të cituar më sipër, ku përcaktohet se: “Veprimtaria e Autoritetit” financohet tërësisht nga të ardhurat e realizuara nga vetë ai. Të ardhurat e realizuara, por të pashpërndara në fund të vitit të parë buxhetor të veprimtarisë, mbarten për vitin pasardhës dhe reflektohen në nivelin e tarifave. *Në vitet në vazhdim, fondet e papërdorura derdhen tërësisht në Buxhetin e Shtetit*”, për arsye se bie ndesh me marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga qeveria në sektorin e aviacionit civil.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Të analizohen nga Drejtoria Ekzekutive dhe Këshilli Drejtues i AAC-së të gjitha rekomandimet e përcaktuara dhe të lëna nga KLSH-ja në auditimin e mëparshëm, duke hartuar një program të veçantë me afate të përcaktuara dhe persona përgjegjës.

Menjëherë

2. Këshilli Drejtues i AAC të shfuqizojë vendimin e tij nr. 5, datë 20.01.2011 marrë në kundërshtim me VKM-të nr. 304, datë 08.05.2003, nr. 870, datë 14.12.2011 “Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive dhe të institucioneve buxhetore, kur dalin jashtë shtetit” dhe nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik”.

Menjëherë

3. Shpenzimet për udhëtim e dieta, për shpenzime të paguara me para në dorë (CASH), t’u rimbursohen punonjësve të AAC vetëm kundrejt paraqitjes së dokumentit tatimor përkatës, të shoqëruar me faturën e printuar nga kasa elektronike fiskale, lëshuar nga subjekti shitës, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6,

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe auditimin”, neni 4 pika 19, neni 16 pika 2.

Menjëherë

3. AAC të identifikojë nevojat për mallra, shërbime e punime ndërtimi dhe t’i prokuroje ato në përputhje të plote me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vazhdimisht

4. Të studiohen nga Drejtoritë Teknike dhe Drejtoria Shërbimeve Mbështetëse dhe programohen në buxhet, bazuar në kërkesat e argumentuara dhe arsyetuara të drejtorëve të drejtorive, nisur nga përshkrimi i punës së përcaktuar në rregulloren e brendshme, për shpenzimet për studime të thelluara pasuniversitare, master dhe studime afatgjata për drejtuesit dhe punonjësit e autoritetit.

Vazhdimisht

5. Të hartohen e t’i paraqiten për miratim Ministrit të MPPT, tarifat që do të zbatohen nga AAC, për shërbimet që kryen, në zbatim të nenit 9 pika 2 të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", neneve 6, 17 të ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, pasi nga veprimet dhe mosveprimet e strukturave drejtuese dhe vartëse janë shkaktuar efekte financiare negative në të ardhurat e AAC-së **në vlerën 1,986,116 Euro** si dhe favorizuar kompanitë ajrore “Belle Air” dhe “Albania Airlines”.

Menjëherë

6. Në zbatim të pikës 5.4, 6.6 të rregullores së brendshme të këshillit drejtues, t’i paraqiten këshillit drejtues projekt-vendime e relacione të konfirmuara nga struktura juridike dhe struktura teknike përkatëse e AAC, sipas kompetencës dhe lajmërimet për mbledhjet e këshillit drejtues, së bashku me materialet për t’u trajtuar në mbledhjen përkatëse, e t’i vihen në dispozicion këtij këshilli të paktën 5 dite kalendarike para ditës së mbledhjes.

Vazhdimisht

7. Drejtoritë Teknike të hartojnë e miratojnë tek Drejtori Ekzekutiv, programet e punës vjetore, tre mujore, mujore dhe të dokumentojnë punën e bërë për zbatimin e këtyre programeve, nëpërmjet raporteve përkatëse të administruara në formë të shkruar në arkivin e AAC.

Vazhdimisht

8. Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues i AAC, të analizojnë raportet finale të auditimit të brendshëm, dhe për të metat e mangësitë e cilësuar në këto raporte, të marrë masat përkatëse ndaj drejtorëve të drejtorive, përgjegjësve të sektorëve dhe specialistëve të cilësuar përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet në ushtrimin e detyrave funksionale.

Vazhdimisht

9. AAC të hartojë dhe miratojë një udhëzim për metodologjinë e hartimit të programeve të zhvillimit ekonomik-financiar, të bëhen analiza dhe vlerësime të hollësishme tekniko-

ekonomiko-financiare në mënyre që të shmangen në maksimum ndryshimet e pjeshme në programit.

Vazhdimisht

10. Drejtori Ekzekutiv i shoqërisë të shqyrtojë dhe analizojë shkaqet, faktorët dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për mosrealizimin e investimeve.

Vazhdimisht

11. Të rakordohet ndërmjet AAC dhe Aeroportit Ndërkombëtar “Nene Tereza” Rinas, për saktësimin e të dhënave në lidhje me numrin e pasagjereve të terminuar, për periudhën e vitit 2010-2011 e në vijim, për të cilët aplikohet tarifa e sigurisë dhe të dhënave për fluturimet me “Charter”, duke sistemuar diferencat përkatëse.

Vazhdimisht

12. T’i bashkëlidhen pagesave të kryera dhe atyre që do të kryhen për telefoni celulare, faturat e kompanisë celulare që ka kryer shërbimin, për llogari të punonjësit, në të kundërt të mos kryhen pagesa dhe pagesat e kryera pa këtë dokumentacion të arkëtohen nga përfituesit, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6, VKM nr. 343, datë 11.07.2002 “Për pajisjen me numër telefoni celulare të personave juridik publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publik”.

Vazhdimisht

13. Autoriteti i Aviacionit Civil të përgatisë një dokument ku të përshkruajë organizmin dhe procedurat kontabël, i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së auditimit.

Menjëherë

14. AAC të raportojë tek MPPT për veprimtarinë, përfshirë të gjitha vendimet e marra nga këshilli drejtues, pasqyrat financiare vjetore, realizimin e planit të të ardhurave e të shpenzimeve, licencat e dhëna, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative.

Vazhdimisht

15. Organet drejtuese duhet të rishikojnë strukturën organizative të AAC-së në përputhje me rregulloret e miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues nr. 9 e 10, datë 24.10.2011.

Menjëherë

16. Të plotësohen dosjet e personelit në përputhje me VKM. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjeve të regjistrit të personelit”, dhe urdhrin të brendshëm të Drejtorit Ekzekutiv me nr. 4/2, date 12.07.2010.

Menjëherë

17. Të identifikohen nevojat për trajnime të stafit, ku të përcaktohen nevojat, kriteret, numri i personave, funksionet që kryejnë, kohën e nevojshme, subjektet trajnuese në fushën e aviacionit civil, dhe t'i paraqiten në mënyrë analitike për miratim Drejtorit Ekzekutiv, Këshillit Drejtues dhe Ministrin të MPPT, në zbatim të ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 "Për autoritetin aviacionit civil", neni 6, pika "d", neni 18 pika 2.

Vazhdimisht

18. Të analizohet shkalla e ulët e realizimit të procedurave gjatë vitit 2011, pasi nga krahasimi i procedurave të parashikuara me ato të realizuara kemi një përqindje shumë të ulët realizimi.

Vazhdimisht

19. Të prokurohen objektet në përputhje me regjistrin e parashikimit të prokurimeve, procedurat dhe fondet e parashikuara, dhe të mos ndahet fondi i parashikuar për objektet gjatë vitit.

Vazhdimisht

20. Në prokurimin e fondeve të zhvillohet procedura e prokurimit "Tender i Hapur" dhe të argumentohet në çdo rast arsyet e përdorimit të procedurave të tjera të prokurimit, përdorimi i së cilës nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, nxit konkurrencën, siguron trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, qëllimi i ligjit "Për prokurimin publik".

Vazhdimisht

21. Të bëhet një planifikim më i studiuar i nevojave për prokurim pasi kjo ka sjellë mosvënien në përdorim të mallrave të blera.

Vazhdimisht

22. Komisioni i vlerësimit të ofertave të përbëhet nga specialistë të fushës, që të sigurohet profesionalizëm gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave.

Vazhdimisht

23. Të ngrihet Njësia e Prokurimit në fillim të vitit kalendarik dhe të trajnohen anëtarët e saj, në mënyrë që të mos ketë më anulime procedurash për gabime teknike.

Vazhdimisht

24. Të analizohen arsyet e anulimit të procedurave të prokurimit, ripërtëritjen disa here të tyre, gjë që ka sjellë që nevojat për mallrat dhe shërbimet të mos jenë koherente.

Vazhdimisht

25. Autoriteti Kontraktor të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojnë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme e efektivitet në përdorimin e fondeve publike.

Vazhdimisht

26. Ti kushtohet vëmendje e duhur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor apo Titullari i Autorizuar i Raportit Përmbledhës, në lidhje me ecurinë e procedurës së prokurimit, shqyrtimin dhe vlerësimin nga KVO të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik, pasi në disa raste nuk është korrekt.

Vazhdimisht

27. Autoriteti kontraktor të ngrëjë komisione me specialistë dhe ekspertë të fushës, për marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e mallrave e shërbimeve, në mënyrë të veçantë kontrata me objekte specifike, për të evituar firmosjen dhe marrjen në dorëzim në mënyrë fiktive të tyre.

Vazhdimisht

28. Në përfundim të kontratave të lidhura, autoriteti kontraktor të përgatisë raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.

Vazhdimisht

29. Rekomandojmë që në kuadrin e zbatueshmërisë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit të MFK-se të ketë me tepër kualifikime e seminare për kuptimin e ligjit, mënyrën e analizës së Menaxhimit të riskut, për tu njohur më mirë me konceptet e ligjit si dhe komponentët e MFK, për të gjithë menaxheret e njësisë, me qëllim zbatimin sa me të mirë të tyre në praktikë.

Menjëherë

30. AAC duhet të përqendrohet, krahas përcaktimit të misionit, strategjisë dhe objektivave, në hartimin e planeve konkrete të veprimit, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre. Në planin e veprimeve të AAC-së duhet të përfshihen hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë menaxhimin e riskut në linjë me hartimin e programit ekonomik.

Menjëherë

31. Të ngrihet një grup i specializuar nga AAC për auditimin e zbatimit të kontratës së lidhur me fondacionin “Akademia e Aeronautikës Shqiptare”, i cili të verifikojë ditët e punës së Fondacionit në zbatim të kontratës dhe raporteve të sjella nga konsulentët, pasi nga auditimi me zgjedhje vetëm për muajin nëntor 2011 ka rezultuar diferencë **në vlerën 4,386,666 lekë, dëm ekonomik**, i ardhur si rezultat i diferencës së ditëve (FT) të parashikuara në kontratë me ditët e punuara dhe të likuiduara.

Menjëherë

32. Të përcaktohet nga Këshilli Drejtues masa e shpërblimit të sekretarit, në analogji me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 dhe udhëzim nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, ku është përcaktuar që shpërblimi për sekretarin e këshillit mbikëqyrës varion nga 5,000 deri në 15,000 lekë në muaj në varësi me rëndësinë e shoqërisë aksionare.

Menjëherë

33. T'i kërkohet IKLD hetimi administrativ i veprimeve të ish Drejtorit Ekzekutiv z. Ervin Mazniku, në lidhje me licencimin dhe nënshkrimin e kontratave nr. 984/6, datë 15.08.2011 me objekt "Asistencë teknike dhe trajnime personeli" në vlerën 21,000 mijë lekë me TVSH dhe nr. 4/1, datë 03.01.2012 në vlerën 4,200 mijë TVSH, për arsye se si licencimi dhe procedura e zhvilluar për prokurimin e fondeve me objekt: "Asistencë teknike dhe trajnime personeli" është bërë në kundërshtim të plotë me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", pasi titullari i autoritetit ka qenë në konflikt të hapur interesi me themeluesit e fondacionit.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të kërkohen në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, të ardhurat në udhëtimet Charter, të cilat për vitet 2010-2011 arrijnë **vlerën 405,650 Euro**, nga kompanitë ajrore [REDAKTUAR] etj, sipas lidhjeve 1, 2, 3, 4, 5, 6 që i bashkëlidhen vendim nr. 492, datë 30.6.2005 "Për caktimin e tarifave të shërbimeve ... në aviacionin civil", trajtuar në faqen 25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. T'i kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 4,386,666 lekë**, fondacionit [REDAKTUAR], dëm ekonomik i ardhur si rezultat i diferencës së ditëve (FT) të parashikuara në kontratë me ditët e punuara dhe të likuiduara për muajin nëntor 2011, trajtuar në faqet 83-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3. T'i kërkohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, arkëtimi i detyrimit ndaj buxhetit të shtetit për derdhjen e TVSH-së **në vlerën 4,200,000 lekë**, nga OJF [REDAKTUAR] sipas kontratës nr. 984/6, datë 15.08.2011 me objekt "Asistencë teknike dhe trajnime personeli" në vlerën 21,000 mijë lekë me TVSH, dhe shtesës së kontratës nr. 4/1, datë 03.01.2012 në vlerën 4,200 mijë tvsh, trajtuar në faqet 83-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4. T'i kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **dëmi ekonomik në vlerën 10,761 euro** për vitet 2010-2011, [REDAKTUAR] në lidhje me numrin e pasagjereve të terminuar, për të cilët aplikohet tarifa e sigurisë 2 Euro për çdo pasagjer të hyre dhe dalë nga Aeroporti, ku 25 % e të cilës merret nga AAC, trajtuar në faqen 25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar parregullsisve dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë periudhën 01.09.2010-29.02.2012, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar për çdo praktikë, bazuar në nenin 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 3, kreut X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, i kërkohet Agjencisë së Prokurimit Publik **të**

vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke rekomanduar marrjen e masave administrative e disiplinore për punonjësit:

1. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të njësisë prokurimit.

2. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të njësisë prokurimit, dhe

3. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të njësisë prokurimit.

-Kanë ndryshuar kërkesat e përgjithshme të pranim/kualifikimit, në kundërshtim me DST, kapitulli 5, pika 5.4 “Kushtet e përgjithshme për pjesëmarrje”.

-Nuk kanë kërkuar “Licenca profesionale dhe CV të stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës, numri i tyre me licencat përkatëse”, kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu III “Dokumentet e tenderit”, pika 3 “Informacione të veçanta”, germa c) “Kontratat e shërbimeve” dhe me Dokumentet Standarde të tenderit, kapitulli 5 “Pjesëmarrja dhe kualifikimi”, pika 5.8 “Kriteret Specifike për Kualifikim”.

-Nuk është dhënë argumentim për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim në hartimin e dokumenteve të tenderit, veprim në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, (me ndryshime).

Këto shkelje janë konstatuar në tenderin me objekt: “Asistencë teknike dhe trajnime personeli”, me vlerë limit të kontratës 22,175,596 leke pa tvsh, zhvilluar më 12.08.2011.

-Nuk kanë plotësuar saktë shtojcën 8- Specifikimet teknike, pasi janë kërkuar plotësimi i dy standardeve të specifikimeve teknike (një e hartuar nga një grup i specializuar në AAC dhe një i miratuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit AKSH me nr. 523/1, datë 11.07.2011), si dhe specifikimet teknike janë në gjuhën angleze, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, e ndryshuar.

Kjo shkelje janë konstatuar në tenderin me objekt: “Blerje Fasilitete Kompjuterike për nevoja të AAC-së”, me vlerë limit të kontratës 672 mijë leke pa tvsh, zhvilluar në datë 08.09.2011.

-Nuk kanë hartuar e paraqitur në APP regjistrin e parashikimeve dhe realizimit të prokurimeve publike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu I, pika 3, germa “b”, si dhe nuk është hartuar e paraqitur në APP raportin e realizimit të prokurimeve publike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu I, pika 3, germa “d”.

-Nuk kanë zhvilluar procedurë të hapur prokurimi për kryerjen e shërbimit të ruajtjes së Aeroportit të Kukësit, në kundërshtim nën 30, të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 2/a;

-Kanë copëzuar e prokuruar me prokurim me vlerë të vogël, fondet për kryerjen e punimeve dhe blerjen e mallrave, në kundërshtim me nenet 1 dhe 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VI, pika 2/a, ku citohet se ... “Autoriteti kontraktor planifikon në fillim të vitit natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë mënyrë”.

-Nuk kanë zbatuar procedurat e përcaktuara nga dispozitat ligjore e nënligjore në lidhjen e kontratës nr. 3/3, datë 04.01.2012 ndarjet AAC dhe SHRSF Toni Security me objekt shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me vlerë 191,700 lekë në muaj me TVSH, me afat të pacaktuar;

-Nuk janë konformë aktet të cilat rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet subjekteve, objekt i TVSH dhe Drejtorive Rajonale të Tatimeve, dokumentet bazë (faturat tatimore të shitjes), e për rrjedhojë subjektet kanë përfituar më tepër;

-Nuk kanë kryer saktë studimin e tregut, duke blerë mallra me çmime më të larta se tregu.
Trajtuar në faqet 72-101, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

4. z. ████████, në cilësinë e juristes së Njësisë së Prokurimeve.

-Nuk ka plotësuar saktë shtojcën 8- Specifikimet teknike, pasi janë kërkuar plotësimi i dy standardeve të specifikimeve teknike (një e hartuar nga një grup i specializuar në AAC dhe një i miratuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit AKSH me nr. 523/1, datë 11.07.2011), si dhe specifikimet teknike janë ne gjuhen angleze, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, e ndryshuar.

Kjo shkelje janë konstatuar në tenderin me objekt: “Blerje Fasilitete Kompjuterike për nevoja të AAC-së”, me vlerë limit të kontratës 672 mijë leke pa tvsh, zhvilluar ne datë 08.09.2011

-Nuk ka zhvilluar procedurë të hapur prokurimi për kryerjen e shërbimit të ruajtjes së Aeroportit të Kukësit, në kundërshtim nenin 30, të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 2/a;

- Ka copëzuar e prokuruar me prokurim me vlerë të vogël, fondet për kryerjen e punimeve dhe blerjen e mallrave, në kundërshtim me nenet 1 dhe 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VI, pika 2/a, ku citohet se ... “Autoriteti kontraktor planifikon në fillim të vitit natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë mënyrë”.

- Nuk ka zbatuar procedurat e përcaktuara nga dispozitat ligjore e nënligjore në lidhjen e kontratës nr. 3/3, datë 04.01.2012 ndarjet AAC dhe SHRSF Toni Security me objekt shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me vlerë 191,700 lekë në muaj me TVSH, me afat të pacaktuar;

- Nuk janë konforme aktet të cilat rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet subjekteve, objekt i TVSH dhe Drejtorive Rajonale të Tatimeve, dokumentet bazë (faturat tatimore të shitjes), e për rrjedhojë subjektet kanë përfituar më tepër;

- Nuk ka kryer saktë studimin e tregut, duke blerë mallra me çmime më të larta se tregu.

-Ka hartuar kontratë me fuqi prapavepruese, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 58 “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 4 ku thuhet “...Kontrata hyn në fuqi kur nënshkruhet nga ofertuesi fitues dhe nga autoriteti kontraktor”.

Trajtuar në faqet 72-101, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

5. z. ████████, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- Ka kualifikuar ofertuesit/kandidat, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 LPP, kreut V, e RPPP dhe DT “kërkesat e pranim/kualifikimit”;

- Ka kualifikuar operatorin ekonomik në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe VKM nr. 1, date 10.01.2007, e ndryshuar, kreu V, pika 4 “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, germa ç.

- Ka nënshkruar dokumentacioni për zbatimin e kontratës me objekt “Asistencë teknike dhe trajnime personeli” pa urdhër zyrtar me shkrim, autorizim ose dokument tjetër të barasvlershëm nga Titullari i AAC ose me firmë të deleguar të tij.

Këto shkelje janë konstatuar në tenderat me objekt:

- “Asistencë teknike dhe trajnime personeli”, me vlerë limit të kontratës 22,175,596 lekë pa tvsh, zhvilluar më 12.08.2011.

- “Blerje Fasilitete Kompjuterike për nevoja të AAC-së”, me vlerë limit të kontratës 672 mijë leke pa tvsh, zhvilluar ne datë 08.09.2011.

Trajtuar në faqet 79-101, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

6. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

7. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- Kanë kualifikuar operatorin ekonomik në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, e ndryshuar, kreu V, pika 4 “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, germa ç.

- Kanë kualifikuar ofertuesit/kandidat, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 LPP, kreu V, e RRPP dhe DT “kërkesat e pranim/kualifikimit”;

Këto shkelje janë konstatuar në tenderin me objekt: “Asistencë teknike dhe trajnime personeli”, me vlerë limit të kontratës 22,175,596 lekë pa tvsh, zhvilluar më 12.08.2011.

Trajtuar në faqet 79-101, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

8. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të KVO-së dhe të anëtarit të komisionit për kolaudimin e mallrave.

Ka kualifikuar operatorin ekonomik në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe VKM nr. 1, date 10.01.2007, e ndryshuar, kreu V, pika 4 “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, germa ç.

Kjo shkelje janë konstatuar në tenderin me objekt: “Blerje Fasilitete Kompjuterike për nevoja të AAC-së”, me vlerë limit të kontratës 672 mijë leke pa tvsh, zhvilluar ne datë 08.09.2011.

Për marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e pajisjeve kompjuterike jo në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në DT, duke vepruar në kundërshtim me kontratën e lidhur.

Nga kontrolli i specifikimeve teknike të mallit të ardhur nga kontraktori “BOLT” shpk, krahasuar me specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentet e tenderit dhe të ofertuara e të kontraktuara rezultoi se ka mospërputhje për pajisjet të cilat kanë ardhur me parametra teknik më të ulët se ato të ofertuar dhe të kontraktuar si dhe nuk kanë ardhur në përputhje me markën e ofertuar (HP), por kanë ardhur me marka të ndryshme.

Për mungesën e dokumentacionit shoqërues të mallit Certifikatë cilësie dhe Certifikatën e origjinës së mallit, pasi bazuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, Shtojca 7, pika 2, kapitulli III. 1.3 Kapaciteti teknik, pika 6, ky operator ka paraqitur një deklaratë që në momentin e dorëzimit të mallit ai do të paraqesë këtë dokumentacion, kriter ky kualifikues.

Trajtuar në faqet 79-101, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

9. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

10. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

11. zj. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Ka kualifikuar operatorin ekonomik në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe VKM nr. 1, date 10.01.2007, e ndryshuar, kreu V, pika 4 “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, germa ç.

Kjo shkelje janë konstatuar në tenderin me objekt: “Studim-Projektim i godinës së AAC”, me vlerë limit të kontratës 1,118,400 leke pa tvsh, zhvilluar datë 06.06.2011.
Trajtuar në faqet 79-101, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

12. z. ██████, me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse sipas urdhrin nr. 237, datë 01.08.2011, dhe

13. z. ██████, me detyrë Inspektor i Matjes se Performancës e Kualitetit, sipas urdhrin nr. 236, datë 01.08.2011, “Inspektor i Operimeve”, Sipas urdhrin të brendshëm nr 42/1, datë 10.02.2012 “Inspektor në Sektorin e Menaxhimit të sistemit të Sigurisë”, sipas urdhrin nr. 122 datë 30/3/2012.

Për arsye se:

- Kanë copëzuar e prokuruar me prokurim me vlerë të vogël, fondet për kryerjen e punimeve dhe blerjen e mallrave, në kundërshtim me nenet 1 dhe 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VI, pika 2/a, ku citohet se ... “Autoriteti kontraktor planifikon në fillim të vitit natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë mënyrë”.

- Nuk kanë zbatuar procedurat e përcaktuara nga dispozitat ligjore e nënligjore në lidhjen e kontratës nr. 3/3, datë 04.01.2012 ndarjet AAC dhe SHRSF Toni Security me objekt shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me vlerë 191,700 lekë në muaj me TVSH, me afat të pacaktuar;

- Nuk janë konforme aktet të cilat rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet subjekteve, objekt i TVSH dhe Drejtorive Rajonale të Tatimeve, dokumentet bazë (faturat tatimore të shitjes), e për rrjedhojë subjektet kanë përfituar më tepër;

- Nuk kanë kryer saktë studimin e tregut, duke blerë mallra me çmime më të larta se tregu.

Trajtuar në faqet 79-101, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

E. MASA DISIPLINORE

a) Bazuar në germën “e”, pika 1, e nenit 39, kapitullit VII Etika në Punë, të Rregullores së Brendshme të AAC, kërkojmë të fillojnë procedura për dhënien e masës disiplinore:

“Largim nga puna në Autoritet”

Për z. ██████, me detyrë Zv/ Drejtor Ekzekutiv, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor (i autorizuar)

Për shkeljet flagrante të konstatuara në Autoritetin e Aviacionit Civil, lidhur me:

-Veprime fiktive të Autoritetit kontraktor në zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe në vlerësimin e ofertave pasi anëtarë të KVO të përcaktuar në Urdhrin e prokurimit kanë deklaruar se nuk ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave në dy procedura prokurimi elektronike, por dikush tjetër ka hyrë në sistem dhe ka vlerësuar për to.

-Papërgjegjshmëri e organeve drejtuese të AAC, të Drejtorit Ekzekutiv dhe N/Drejtori Ekzekutiv, të cilët megjithëse i është bërë prezent një akt abuziv në lidhje me vlerësimin e ofertave në një procedurë prokurimi, nuk kanë marrë masa dhe dënuar personat përgjegjës.

-Pajisjet e sjella nga kompania “BOLT” shpk me objekt “Blerje facilitete kompjuterike” të marra në dorëzim nga AAC janë më parametra me të ulët se specifikimet teknike të kërkuara në

Dokumentet e Tenderit (miratuar nga AKSH) dhe të përcaktuara në Kontratën e lidhur me operatorin fitues.

-Gjate vitit 2011 për procedurat e prokurimit të planifikuara të zhvillohen me procedurë prokurimi "Tender i hapur", është përdorur procedura "Me negociim pa shpallje paraprake e kontratës", ose është copëtuar fondi duke zhvilluar disa procedura me blerje te vogla.

-Njësia e Prokurimit, e ngritur me shkresën nr. 61, datë 19.01.2011 nga Titullari i Autorizuar në fillim të vitit në disa raste ndryshon me Njësinë e Prokurimit e përcaktuar për çdo procedurë dhe në një rast në përbërjen e tij nuk ka pasur jurist, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, date 01.10.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", kreu V, pika 1, germa b).

-Nuk është ngritur grupi për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës për cdo procedurë prokurimi, veprim i cili bie në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V "Zhvillimi i procedurave".

-Emërimi i anëtareve të komisionit të vlerësimit të ofertave nuk është bërë në përputhje me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar Kreu V pika 2/ç ku përcaktohet se "Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor, përbëhet nga jo më pak se 3 persona, specialistë të fushës.

-Në një procedurë prokurimi nuk është përcaktuar Njësia e prokurimit, por KVO ka bërë njëkohësisht edhe detyrën e Njësisë së prokurimit, veprim i cili bie në kundërshtim me dispozitat ligjore "Për prokurimin publik" ku përcaktohet se Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të KVO...".

-Është lidhur kontratë me fuqi prapavepruese, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 58 "Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës", pika 4 ku thuhet "...Kontrata hyn në fuqi kur nënshkruhet nga ofertuesi fitues dhe nga autoriteti kontraktor".

-Është paguar kontraktori "Shtiqni" shpk, për periudhën 01.07.2011 deri 15.07.2011 për të cilën nuk ka kontratë të lidhur në shumën 342 mijë lekë, dëm ekonomik.

-Për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara gjatë zhvillimit dhe vlerësimit të procedurave të prokurimit të miratuara me firmosjen e Raportit përfundimtar të vlerësimit nga titullari i Autorizuar i Autoritetit kontraktor.

-Për mos hartimin e një raporti përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratave, në përfundim të afatit të kontratës, veprim i cili bie në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu X, pika 2 "Mbikëqyrja e kontratës", germa b).

-Ndërhyrjen në sistemin e prokurimit elektronik, duke ndryshuar fjalëkalimin e z.Fisnik Tabaku, me detyrë Drejtor i Mbikëqyrjes dhe së Shërbimit të Navigimit Ajror, në cilësinë e Anëtarit dhe Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pa dijeninë ose kërkesën tij, dhe duke vlerësuar ofertat në emër të tij.

Veprime këto në kundërshtim të plotë me nenin 36, Rregullat e zbatueshme të komunikimeve elektronike, Kreu IV Prokurimi elektronik të ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", ndryshuar, ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik" dhe VKM nr. 659, datë 3.10.2007 "Për rregullat e kryerjes se procedurave të prokurimit publik me mjete elektronike", dhe udhëzimet e APP të dala në zbatim të dispozitave ligjore, të kryera me dashje për vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit me objekt "Blerje pajisje dhe orendi zyre" dhe "Blerje Fasilitete Kompjuterike për nevoja të AAC-së".

Këto përfundime bazohen në shkresën e z. [REDAKTUAR] nr. extra , datë 20.10.2011 drejtuar z. [REDAKTUAR] Nëndrejtor Ekzekutiv i AAC (në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor) dhe për dijeni z.

██████ Drejtor Ekzekutiv, me objekt: Informacion në lidhje me procedurën “kërkesë për propozim” me mjete elektronike me objekt “Blerje pajisje dhe orendi zyre”, ku denoncohen fakte se:

Më datën 20.10.2011, është bërë me dije për nënshkrimin e një procesverbalit. Procesverbal i cili bënte fjale për skualifikimin e një kompanie në lidhje me tenderin “Blerje pajisje dhe orendi zyre”.

Z. ██████ bën me dije se komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka bërë vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik në formë elektronike, pasi gjatë kësaj periudhe ka qenë jashtë shtetit dhe konstaton se fjalëkalimi që ka pasur si përdorues janë ndryshuar pa dijeni dhe kërkesën e tij. Pra një person tjetër ka kryer procedurën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomik.

Në vijim z. Tabaku, pasi ka verifikuar dokumentet e operatorëve ekonomik të paraqitur në formë elektronike (duke përdorur fjalëkalimet e ndryshuara 1111) ka vërejtur se arsyet e skualifikimit të kompanisë ██████ e cila ka edhe ofertën më të ulët janë të pa bazuara në ligj. Kjo kompani ka paraqitur të njëjtat specifitime teknike pa asnjë ndryshim nga kërkesat e Autoritetit. Pra nuk vërehet as deviacioni më i vogël. Skualifikimi i kësaj kompanie do të çonte në një dëm ekonomik për Autoritetin Kontraktor.

-Me shkresën nr. ska, datë 23.05.2012 me lëndë: Informacion në lidhje me procedurën “kërkesë për propozim” me objekt “Blerje Fasilitete Kompjuterike për nevoja të AAC-së”, z. Fisnik Tabaku denoncon faktet se: Nuk ka kryer asnjë veprim që ka ndikuar në procesin e përzgjedhjes së firmës fituese. Gjithashtu konfirmon se nuk ka qenë pjesë e asnjë mbledhje të mbajtur me qëllim vlerësimin e procedurës “Kërkesë për propozim” me objekt “Blerje Fasilitete Kompjuterike për nevojat e AAC-se për vitin 2011.

Në një verifikimin që është bërë nga ana e tij tek portali i APP-se në një kohë të mëvonshme, rezultonte se vlerësimi në emrin e tij ishte bërë nga dikush tjetër. Aq më tepër në atë kohë ka konstatuar që fjalëkalimi i tij si përdorues ka ndryshuar pa dijeninë ose kërkesën e tij, duke e bërë të sigurt që dikush tjetër ka bërë vlerësimin për z. Tabaku.

-Me shkresën nr. 614/19, datë 28.05.2012, z. Dritan Nelaj në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël, denoncon faktet se nuk është nënshkrimi i tij në procesverbalet datë 09.02.2011 dhe 10.02.2011, sipas formularëve nr. 3 e 4.

Trajtuar në faqet 72-101, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

b) Bazuar në germën “d”, pika 1, neni 39, kapitulli VII, Etika në Punë, të Rregullores së Brendshme të AAC, kërkojmë të fillojnë procedura për dhënien e masës disiplinore:

“Paralajmërim me shkrim për largim nga puna me afat shlyerje 1 vit”

Për z. ██████, me detyrë “Ish Drejtor i Ruajtjes së Cilësisë dhe Auditimit Teknik”

-Ka nënshkruar dokumentacioni për zbatimin e kontratës me objekt “Asistencë teknike dhe trajnime personeli” pa urdhër zyrtar me shkrim, autorizim ose dokument tjetër të barasvlershëm nga Titullari i AAC ose me firmë të deleguar të tij,

-Dokumentacioni teknik për zbatimin e kontratës nuk i justifikon likuidimin sipas zërave të kontratës.

- Nuk ka monitoruar dhe raportuar tek Drejtori Ekzekutiv për performancën teknike të institucionit;
 - Nuk ka ndjekur zbatimin e Planit Shtetëror të Sigurisë dhe nuk ka menaxhuar sistemin e cilësisë teknike të AAC-së;
 - Nuk ka mbikëqyrur në mënyrë të vazhdueshme aplikimin e standardeve teknike,
 - Nuk ka ndjekur e menaxhuar plane korrigjuese të paraqitura nga Drejtoritë Teknike;
 - Nuk ka vlerësuar dhe analizuar nivelin e efektivitetit të standardeve në lidhje me performancën e subjekteve të cilat mbikëqyren nga AAC;
 - Nuk ka mbikëqyrur eficienten e drejtorive teknike të AAC –se,;
 - Nuk ka raportuar për performancën e sektorëve teknike tek drejtoret e Drejtorive Teknike, si dhe nuk ka dhënë rekomandime për përmirësime aty ku është e nevojshme;
 - Nuk ka përgatitur një Manual Operacional dhe Metodologjinë e Organizimit të Procesit të Auditimit Teknik për kryerjen e proceseve të ngarkuara kësaj drejtorie dhe miratimin e tij tek Drejtori Ekzekutiv;
 - Nuk ka identifikuar nevojat për trajnim të stafit.
- Trajtuar në faqet 40-44 dhe 88-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. z. █████ në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Kolaudimit të mallrave.

Për marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e pajisjeve kompjuterike jo në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në DT, duke vepruar në kundërshtim me kontratën e lidhur.

Nga kontrolli i specifikimeve teknike të mallit të ardhur nga kontraktori “BOLT” shpk, krahasuar me specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentet e tenderit dhe të ofertuara e të kontraktuara rezultoi se ka mospërputhje për pajisjet të cilat kanë ardhur me parametra teknik më të ulët se ato të ofertuar dhe të kontraktuar si dhe nuk kanë ardhur në përputhje me markën e ofertuar (HP), por kanë ardhur me marka të ndryshme.

Për mungesën e dokumentacionit shoqërues të mallit Certifikatë cilësie dhe Certifikatën e origjinës së mallit, pasi bazuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, Shtojca 7, pika 2, kapitulli III. 1.3 Kapaciteti teknik, pika 6, ky operator ka paraqitur një deklaratë që në momentin e dorëzimit të mallit ai do të paraqesë këtë dokumentacion, kriter ky kualifikues.

Trajtuar në faqet 92-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

c) Bazuar në germën “b”, pika 1, neni 39, kapitulli VII, Etika në Punë, të Rregullores së Brendshme të AAC, kërkojmë të fillojnë procedura për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me shkrim me afat shlyerje 6 (gjashtë) muaj”

1. z. █████, me detyrë “Nëndrejtor Ekzekutiv”

2. z. █████, me detyrë “Nëndrejtor Ekzekutiv”

Për arsye se:

- Nuk kanë ndjekur zbatimin e detyrave funksionale të Drejtorive Teknike të AAC,
 - Nuk kanë propozuar masa për përmirësimin e efikasitetit dhe eficientës në punë të Drejtorive Teknike të AAC-së;
 - Mos hartimi i programeve ekonomike bazuar ne nevojat e mundësitë reale të AAC.
- Trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

3. znj. [REDACTED], me detyrë “përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit Financiar”:

- Për mos vendosjen e një database-i financiar për të përmirësuar raportimin dhe për t'i shërbyer me koherence sistemit financiar të drejtorisë;
 - Për mos hartimin e programeve ekonomike bazuar ne nevojat e mundësitë reale të AAC
- Trajtuar në faqet 46-47, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

4. znj. [REDACTED] “Specialiste e Programimit dhe Statistikës”:

- Për pa saktësi në hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe afatgjata;
 - Për mos kryerjen e rakordimit të paktën një herë në vit për saktësimin e të dhënave në lidhje me numrin e pasagjerëve të terminuar, dhe derdhjen e tarifës së sigurisë me Tirana International Aeroport “Nënë Tereza”;
 - Për mos hartimin e programeve ekonomike bazuar ne nevojat e mundësitë reale të AAC;
 - Pasi nuk ka hartuar një udhëzim për metodologjinë e hartimit të programeve të zhvillimit ekonomik-financiar të AAC.
- Trajtuar në faqet 46-47, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

5. z. [REDACTED], me detyrë “Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Shërbimit të Navigimit”, sipas urdhrin nr. 2/16, datë 01.07.2010,

6. z. [REDACTED], me detyrë “Inspektor i Lejeve të Fluturimit dhe Koordinimit të Sloteve”, sipas urdhrin nr. 2/8, date 01.07.2010.

Për arsye se:

- Sektori i Lejeve të Fluturimit dhe Koordinimit të Sloteve, ka dhënë leje të fluturimeve “Charter”, në leje të fluturimeve “schedul”, në kundërshtim me ligjet, rregulloret dhe udhëzimet në fuqi, si edhe me parashikimet e përfshira në AIP-in e Republikës së Shqipërisë për këtë çështje.

Trajtuar në faqet 29-35, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

7. z. [REDACTED], me detyrë “Drejtor i Sigurisë Ajrore”, dhe

8. z. [REDACTED], me detyrë “Ish Drejtor i Sigurisë Ajrore”

- Nuk ka përgatitur një Manual Operacional për kryerjen e proceseve të ngarkuara kësaj drejtorie në përputhje me standardet e ICAO dhe rregulloret e BE-së,
- Nuk ka hartuar planin e inspektimeve dhe auditimeve të avionëve dhe organizatave të mirëmbajtjes së operatorëve.
- Nuk ka data-base për Lëshimin e Certifikatave dhe Aprovimeve ;
- Nuk ka rekomanduar masa korrigjuese të rezultuara nga Auditet.

Trajtuar në faqet 35-40, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

9. znj. [REDACTED], me detyrë “Inspektore e Vlefshmërisë Ajrore”

- Nuk ka zhvilluar procedurat për realizimin e mbikëqyrjes së Vlefshmërisë Ajrore
- Nuk ka bërë azhurnimin e tyre,
- Nuk ka administruar të dhënat mbi vlefshmërinë ajrore.

Trajtuar në faqet 35-40, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

10. z. [REDACTED], me detyrë “Përgjegjës AOC”, dhe

11. znj. [REDACTED] me detyrë “Inspektor AOC”

-Nuk ka përgatitur draftet në lidhje me operimet e avionit dhe Inspektimeve SAFA sipas rekomandimeve dhe standardeve praktike të ICAO dhe të rregulloreve të Aviacionit Civil Ndërkombëtar;

-Nuk ka administruar të dhënat dhe dokumentacionin që ka të beje me COA.

Trajtuar në faqet 35-40, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

12. znj. [REDACTED], me detyrë “Inspektore në Sektorin Licencimit të Stafit dhe Ekuipazhit”

13. z. [REDACTED], me detyrë “Inspektor në Sektorin e Licencimit të Stafit dhe Ekuipazhit”

-Nuk kanë përgatitur tekstet rregullatore në lidhje me licencat aeronautike dhe procedurat e mbikëqyrjes së licencave, sipas rekomandimeve dhe standardeve praktike të ICAO dhe rregulloreve të Aviacionit Civil Ndërkombëtar;

-Nuk kanë mbikëqyrur lëshimin dhe rinovimin licencave aeronautike: ekuipazhit të kabinës, personelit të kabinës, mekanikeve, etj.;

-Nuk kanë përcaktuar procedurat në lidhje me vlefshmërinë e licencave të huaja;

-Nuk kanë kontrolluar trajnimet e personelit aeronautikë;

-Nuk kanë komunikuar me autoritetet e aviacionit civil të shteteve të tjera, në lidhje me licencat aeronautike;

-Nuk kanë përgatitur programin e auditimit dhe atë të inspektimeve të operatoreve ajrore dhe organizatave të mirëmbajtjes, kryen inspektime dhe është pjesë e auditimeve për mbikëqyrjen e licencave të personelit, për të siguruar vazhdueshmërinë e përmbushjes së kriterëve për të cilat është dhënë Licenca;

-Nuk kanë data-base për administrimin e të dhenarë dhe dokumentacionin që ka të beje me Licencimin e Personelit.

Trajtuar në faqet 35-40, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

**14. z. [REDACTED] detyrë ish Inspektor në Regjistrimin e Avionëve
Sektori i Regjistrimit të Avionëve:**

-Nuk ka vlerësuar saktë dokumentacionin e avionëve të paraqitur për regjistrim në AAC;

-Nuk ka kryer inspektime të avionëve të regjistruar në Regjistrin shqiptar të Avionëve Civile, për të garantuar vazhdueshmërinë e të dhënave të regjistruara në regjistër.

Trajtuar në faqet 35-40, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

15. znj. [REDACTED], me detyrë Inspektor në Sektorin e Mirëmbajtjes

-Nuk ka përgatitur tekstet rregullatore në lidhje me rregullat për bazat e mirëmbajtjes dhe procedurat e mbikëqyrjes së tyre, sipas rekomandimeve dhe standardeve praktike të ICAO dhe të rregulloreve të aviacionit civil ndërkombëtar ;

-Nuk ka inspektuar zbatimin nga ana subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si baza mirëmbajtjesh, të rregullave dhe standardeve në fuqi për bazat e mirëmbajtjes.

-Nuk ka databaze të licencimit të personelit teknik të bazave të mirëmbajtjes së avionëve.

Trajtuar në faqet 35-40, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

16. z. [REDACTED] Inspektor në Sektorin e Ekspertizës

17. znj. [REDACTED], me detyrë Inspektore në Sektorin e Ekspertizës dhe

18. znj. [REDACTED], me detyrë Inspektore në Sektorin e Ekspertizës.

-Nuk kanë dada bazë për certifikimin mjekësor për pilotët e transportit komercial dhe inxhinierëve të fluturimit në përputhje me kërkesat mjekësore për Klasën 1 sipas JAR-FCL 3 dhe Aneksit 1 të Konventës së Çikagos.

- Nuk kanë dada bazë për certifikimin mjekësor për pilotët privatë, pilotët e aeroplanëve pa motor, pilotët e balonëve pilotët e aeroplanëve ultra të lehtë, parashutistëve dhe në përputhje me kërkesat mjekësore për Klasën 2 sipas JAR-FCL 3 dhe Aneksit 1 të Konventës së Çikagos.

- Nuk kanë të dhëna për certifikimin mjekësor për kontrollorët e trafikut ajror në përputhje me kërkesat mjekësore për Klasën 3 të bazuara sipas standardeve të EUROCONTROL-it, dhe anëtarëve të ekuipazhit të kabinës në përputhje me kërkesat mjekësore për Klasën 3 sipas JAR-FCL 3.

Trajtuar në faqet 35-40, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

19. z. ██████████, me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse

20. ██████████, me detyrë Përgjegjëse Sektori e Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve, dhe

21. znj. ██████████, me detyrë ish Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve.

- Nuk kanë identifikuar nevojat për trajnim.

- Nuk kanë përgatitur një Manual Operacional për kryerjen e proceseve të ngarkuara kësaj drejtorie dhe miratimin e tij nga Drejtorit Ekzekutiv,

-Nuk kanë zbatuar dispozitat fuqi, në zhvillimin e procedurave të prokurimit për plotësimin e nevojave të Autoritetit për mallra dhe shërbime.

- Nuk kanë mbajtur nën kontroll të plotë administrimin dhe ruajtjen e vlerave materiale e monetare të Autoritetit dhe nuk ka informuar për gjendjen e lëvizjen e mjeteve materiale e monetare në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike.

- Nuk kanë vlerësuar nevojat për staf të ri në procedurat e rekrutimit në bashkëpunim me Drejtorinë e tjera

- Nuk kanë planifikuar, zhvilluar dhe implementuar strategji për menaxhimin dhe zhvillimin e Burimeve Njerëzore, përfshirë rekrutimin dhe politikat e përzgjedhjes, disiplinës, trajnimit, moralin dhe motivimin, zhvillimin kulturor dhe të sjelljes, vlerësimet e performancës dhe çështje të menaxhimit të cilësisë në bashkëpunim dhe bashkërendim me Drejtorinë Ekonomike,

-Nuk kanë përgatitur dhe koordinuar procedurat e punësimit dhe trajnimit në Autoritetin e Aviacionit Civil dhe siguruar përzgjedhjen e personelit të kualifikuar, me eksperience dhe aftësi profesionale në të gjitha nivelet e shërbimit në AAC.

Trajtuar në faqet 47-48, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

22. znj. ██████████, me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Standardizimit dhe Drejtore e Standardizimit dhe Implementimit.

23. ██████████, me detyrë Përgjegjëse Sektorit të Implementimit, dhe

24. ██████████, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Standardizimit Teknik

-Nuk ka përditësuar strategjinë e aviacionit civil

-Nuk ka trajtuar saktë çështje që kanë të bëjnë me përputhshmërinë dhe zbatimin e standardeve teknike në fushën e transportit ajror.

-Nuk ka organizuar seminare për njohjen me standardet ndërkombëtare dhe ndryshimet e tyre.

-Nuk ka hartuar sipas standardeve dhe rregullave në fuqi kontratat që autoriteti nënshkruan me institucione apo subjekte të tjera;
Trajtuar në faqen 48, të Raportit Përfundimtar të Audimit.

ç) Për drejtuesit dhe punonjësit si më poshtë:

1. z. ██████, me detyrë ish Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse sipas urdhrit nr. 6, datë 12.07.2010, larguar nga puna me urdhër nr. 235, datë 01.08.2011, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlera të vogla;
2. z. ██████ – Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, sipas urdhrit nr. 17, datë 02.08.2010, ndërprerje e menjëhershme kontratës, sipas urdhrit nr. 107/1, datë 22.04.2011, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlera të vogla;
3. z. ██████, me detyrë Inspektor i Standardeve Teknike, Mekanike dhe Bazave të Mirëmbajtjes, Inspektor i Licencimit të Stafit dhe Ekuipazhit, zgjidhje e menjëhershme e kontratës 01.10.2010;
4. z. ██████, me detyrë Inspektor i Vlefshmërisë Ajrore, zgjidhje e menjëhershme e kontratës 03.11.2011;
5. z. ██████ Drejtor i Standardizimit dhe Implementimit, larguar 31.12.2011 me vendim nr. 6, datë 29.12.2011;
6. z. Kujtim Karafili, me detyrë Inspektor Ekspertiza Mjekësore, larguar datë 01.10.2011 me urdhrin e brendshëm nr. 297/1, datë 26.09.2011;
7. z. ██████, me detyrë Specialiste IT, Specialiste e Burimeve Njerëzore, larguar me vendim nr. 5, datë 28.10.2011;
8. z. ██████, me detyrë Inspektor në Sektorin e Implementimit të Programeve, Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Teknik, larguar me urdhër të brendshëm nr. 308, datë 04.10.2011;
9. znj. ██████, me detyrë Nëndrejtoreshë Ekzekutive, larguar me urdhër të nr. 39, datë 01.09.2010;
10. z. ██████, me detyrë Inspektor i Mirëmbajtjes, Specialist IT, larguar me urdhrin nr. 70/1, datë 01.11.2011;
11. z. ██████, me detyrë Inspektor në Sektorin e Licencimit të Operatoreve Ajrore, larguar me urdhrin e brendshëm nr. 85, datë 11.11.2010;
12. znj. ██████, me detyrë Përgjegjëse Sektori, Inspektore AOC, larguar me vendim nr. 3 datë 28.10.2011;
13. z. ██████, me detyrë Inspektor në Sektorin e Inspektimit Operacional, Inspektor i Matjes së Sistemit të Sigurisë Ajrore, larguar me urdhrin nr. 119, datë 27.03.2012;
14. znj. ██████, me detyrë Specialiste, Inspektore e Vlefshmërisë Ajrore, Inspektore në Regjistrin e Avionëve, larguar me vendim nr. 4, datë 28.10.2011;
15. znj. Lizabeta Pollo, me detyrë Përgjegjëse të Sektorit të Licencimit të Personelit, Inspektore në Sektorin e Licencimit të Stafit dhe Ekuipazhit, larguar me vendim nr. 2, datë 28.10.2011;
16. z. ██████, me detyrë Jurist në Aeroportin e Kukësit, Inspektor në Sektorin e Implementimit dhe Standardizimit, larguar me urdhër të brendshëm nr. 305, datë 29.09.2011, është tejkaluar masa disiplinore e përcaktuar në nenin 37, ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, nenet 38 dhe 39 e rregullores së brendshme të autoritetit, pasi për këta punonjës AAC ka marrë masën disiplinore “Largim nga puna në Autoritet”, **prandaj masa që do të propozonte grupi i auditimit quhet e ezauruar.**

Ç. KALLZIM PENAL

Bazuar në Kodin Penal, neni 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe 258 “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tender apo ankande publike” propozojmë të bëhet kallëzim penal pranë organeve të prokurorisë, për:

1. z. ██████████, me detyrë ish Drejtor Ekzekutiv i AAC-së

Për shkeljet dhe dëmet e konstatuara buxhetit të Autoritetit të Aviacionit Civil, lidhur me:

- Procedurat me objekt: “Asistencë e huaj dhe trajnime personeli”, duke favorizuar OJF “Akademia e Aeronautike Shqiptare” e licencuar nga vete autoriteti, për arsye se autoriteti kontraktor ka përdorur procedurën e prokurimit “me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës” pa ekzistuar rrethanat e përcaktuara në dispozitat e prokurimit publik, si dhe në dhënien e licencës kësaj kompanie Drejtori Ekzekutiv i autoritetit kanë qenë në konflikt të hapur interesi për arsye të lidhjeve të gjakut me aksionarët e kësaj kompanie të licencuar prej tij.

- Zbatimin e kontratës dhe shtesës së kontratës me objekt “Asistencë e huaj dhe trajnime personeli” me OJF “Akademia e Aeronautike Shqiptare”, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **4,386,666 lekë** i cili ka ardhur si rezultat i diferencës së ditëve (FT) të parashikuara në kontratë me ditët e punuara dhe të likuiduara në fakt për muajin nëntor 2011.

- Nuk ka hartuar dhe miratuar tarifatat sipas përcaktimit në nenin 9 pika 2 të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 "Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë", nenin 6, 17 të ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin aviacionit civil”. Kjo ka sjellë edhe mos aplikimin e tarifës së sigurisë për kompanitë ajrore tarife kjo e re e parashikuar në Ligjin nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin aviacionit civil”, neni 17, **duke shkaktuar efekte financiare negativ në të ardhurat e AAC në vlerën 1,986,116 Euro dhe favorizuar kompanitë ajrore ██████████ dhe ██████████** me veprimet e mos veprimet e tyre, pasi kodi ajror është shpallur me dekretin nr. 5998, datë 12.1.2009 dhe ligji për autoritetin aviacionit civil është shpallur me dekretin nr. 6441, datë 02.03.2010.

- Ka urdhëruar dhënien e lejeve të fluturimeve të rregullta ndërkombëtare (skedul) operatoreve ajror ██████████ “██████████” etj., të cilët operojnë vetëm në periudhën e verës në drejtim të Rinas–Antalya, Sharm El Sheik, Palma, Chania etj., **duke i shkaktuar një efekt financiar negativ në të ardhurat e autoritetit në vlerën 405,650 Euro** (e llogaritur numri i pasagjerëve të terminuar x 10 Euro).

- Nuk ka rakorduar të dhënat e marra nga Aeroporti “Nene Tereza”, në lidhje me numrin e pasagjereve të terminuar, për të cilët aplikohet tarifa e sigurisë 2 Euro për çdo pasagjer të hyre dhe dalë nga Aeroporti, ku 25 % e të cilës e merr AAC, **duke i shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 10,761 Euro.**

- Nuk ka rritur tarifatat për shërbimet, që zbatohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil, sipas lidhjeve 1, 2, 3, 4, 5, 6 që i bashkëlidhen, Vendimit nr. 492, datë 30.6.2005 “Për caktimin e tarifave të shërbimeve ... në aviacionin civil”, duke shkaktuar dëm ekonomik potencial të barabartë me diferencën ndërmjet tarifave të vitit 2005 dhe tarifave të reja ose minimumi indeksimin e tyre si rezultat i normës vjetore të inflacionit.

- Ka urdhëruar blerjen e shërbimeve me procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me vlerë limit 22,176 mijë lekë pa tvsh me objekt “Asistencë teknike dhe trajnime personeli”, është në kundërshtim me nenet 1, 2 neni 33 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, pika 5, pa ekzistuar rrethanat e përcaktuar në dispozitat e cituar më sipër, të cilat kanë shmangur konkurrencën dhe ka favorizuar [REDAKTUAR], pasi AAC me vendimin nr. 1, datë 01.02.2011 ka licencuar këtë OJF me objekt [REDAKTUAR]” në kushtet e konfliktit të hapur të interesit për arsye të lidhjeve të gjakut me aksionarët e saj.

- Ka urdhëruar për kryerjen e procedurave të procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me vlerë limit 4200 mijë lekë me tvsh me objekt “Asistencë teknike dhe trajnime personeli”, është në kundërshtim me nenet 1, 2 neni 33 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, pika 5.

-Ka urdhëruar zgjidhjen e kontratës së punës në mënyre të njëanshme të z. Altin Vrapit, duke shkaktuar efekt financiar negativ në vlerën **1,283,300 lekë**, sipas vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë me objekt “Pagim Page”.

2. z. [REDAKTUAR], me detyrë Zv/ Drejtor Ekzekutiv, në cilësinë e Titullarit të autoritetit kontraktor (i autorizuar).

Për shkeljet flagrante të konstatuar në Autoritetin e Aviacionit Civil, lidhur me:

-Veprime fiktive të Autoritetit kontraktor në zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe në vlerësimin e ofertave pasi anëtarë të KVO të përcaktuar në Urdhrin e prokurimit kanë deklaruar se nuk ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave në dy procedura prokurimi elektronike, por dikush tjetër ka hyrë në sistem dhe ka vlerësuar për to.

-Papërgjegjshmëri dhe mungese kontrolli në cilësinë e Titullarit të Autorizuar, të cilit megjithëse i është bërë prezent një akt abuziv në lidhje me vlerësimin e ofertave në një procedurë prokurimi, nuk ka marrë masa dhe dënuar personat përgjegjës.

-Ndërhyrjen në sistemin e prokurimit elektronik, duke ndryshuar fjalëkalimin e z. [REDAKTUAR], me detyrë Drejtor i Mbikëqyrjes dhe së Shërbimit të Navigimit Ajror, në cilësinë e Anëtarit dhe Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pa dijeninë ose kërkesën tij, dhe duke vlerësuar ofertat në emër të tij.

Veprime këto në kundërshtim të plotë me nenin 36, Rregullat e zbatueshme të komunikimeve elektronike, Kreu IV Prokurimi elektronik të ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ndryshuar, ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, “Për nënshkrimin elektronik” dhe VKM nr. 659, datë 3.10.2007 “Për rregullat e kryerjes së procedurave të prokurimit publik me mjete elektronike”, dhe udhëzimet e APP të dala në zbatim të dispozitave ligjore, të kryera me dashje për vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit me objekt “Blerje pajisje dhe orendi zyre” dhe “Blerje Fasilitete Kompjuterike për nevoja të AAC-së”.

Këto përfundime bazohen në shkresën e z. [REDAKTUAR] nr. extra, datë 20.10.2011 drejtuar z. [REDAKTUAR] Nëndrejtor Ekzekutiv i AAC (në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor) dhe për dijeni z. [REDAKTUAR] Drejtor Ekzekutiv, me objekt: Informacion në lidhje me procedurën “kërkesë për

propozim” me mjete elektronike me objekt “Blerje pajisje dhe orendi zyre”, ku denoncohen fakte se:

Më datën 20.10.2011, është bërë me dije për nënshkrimin e një procesverbali, i cili bënte fjale për skualifikimin e një kompanie në lidhje me tenderin “Blerje pajisje dhe orendi zyre”.

Z. [REDAKTUAR] bën me dije se komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka bërë vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik në formë elektronike, pasi gjatë kësaj periudhe ka qenë jashtë shtetit dhe konstaton se fjalëkalimi që ka pasur si përdorues janë ndryshuar pa dijeni dhe kërkesën e tij. Pra një person tjetër ka kryer procedurën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomik.

Në vijim z. [REDAKTUAR] pasi ka verifikuar dokumentet e operatorëve ekonomik të paraqitur në formë elektronike (duke përdorur fjalëkalimet e ndryshuara 1111) ka vërejtur se arsyet e skualifikimit të kompanisë [REDAKTUAR] e cila ka edhe ofertën më të ulët janë të pa bazuara në ligj. Kjo kompani ka paraqitur të njëjtat specifikime teknike pa asnjë ndryshim nga kërkesat e Autoritetit. Pra nuk vërehet as deviacioni më i vogël. Skualifikimi i kësaj kompanie do të çonte në një dëm ekonomik për Autoritetin Kontraktor.

-Me shkresën nr. ska, datë 23.05.2012 me lëndë: Informacion në lidhje me procedurën “kërkesë për propozim” me objekt “Blerje Fasilitete Kompjuterike për nevoja të AAC-së”, z. [REDAKTUAR] denoncon faktet se: Nuk ka kryer asnjë veprim që ka ndikuar në procesin e përzgjedhjes së firmës fituese. Gjithashtu konfirmon se nuk ka qenë pjesë e asnjë mbledhje të mbajtur me qëllim vlerësimin e procedurës “Kërkesë për propozim” me objekt “Blerje Fasilitete Kompjuterike për nevojat e AAC-se për vitin 2011.

Në një verifikimin që është bërë nga ana e tij tek portali i APP-se në një kohë të mëvonshme, rezultonte se vlerësimi në emrin e tij ishte bërë nga dikush tjetër. Aq më tepër në atë kohë ka konstatuar që fjalëkalimi i tij si përdorues ka ndryshuar pa dijeninë ose kërkesën e tij, duke e bërë të sigurt që dikush tjetër ka bërë vlerësimin për z. [REDAKTUAR].

-Me shkresën nr. 614/19, datë 28.05.2012, z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël, denoncon faktet se nuk është nënshkrimi i tij në procesverbalet datë 09.02.2011 dhe 10.02.2011, sipas formularëve nr. 3 e 4.

Si përfundim konkludojmë se referuar shkeljeve të mësipërme të shoqëruar me dëme dhe efekte financiare negative për AAC-në, kërkojmë që të fillojë procedimi penal, për shpërdorim detyrës dhe shkeljes së barazisë në tender për z. [REDAKTUAR] dhe për shpërdorim detyrës për z. [REDAKTUAR]

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Shefki Jaupi, Lavdie Fshazi, Albana Pengili, Fatmir Iljazi, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

